



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT

Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit

Lënda: Raport i stafit të KKK-së mbi punët e kryera gjatë vitit 2018

Sipas programit të mbledhjeve vjetore të miratuara nga Bordi në mbledhjen e Janarit 2018, për vitin 2018 ishin parashikuar këto detyra:

Janar

- Analiza vjetore e buxhetit dhe punës së kryer nga stafi i KKK për vitin 2017
- Miratimi për publikim i variantit të konsoliduar të SNRF-ve 2017 në gjuhën shqipe
- Miratimi i publikimit për komente të SKK 2 dhe SKK 9 të ndryshuara

Shkurt

- Diskutime mbi formatin, të ftuarit, referimet dhe të tjera për organizimin e Konferencës Shkencore

Mars

- Takim studentor “Kontabiliteti dhe raportimi financiar në Shqipëri – Legjislacioni dhe rregullatori”, Universiteti i Shkodrës;
- Takim studentor “Kontabiliteti dhe raportimi financiar në Shqipëri – Legjislacioni dhe rregullatori”, Universiteti i Korçës;

- Konferenca Shkencore e KKK-së “Përmirësimi i vazhdueshëm i raportimit financiar sfidë për zhvillimin ekonomik dhe integrimin”;
- Raporti i vlerësimit të realizimit të produktit 14 dhe 15 të projektit të Bankës Botërore (trajnimet e SKK-ve dhe SNRF-ve)

Prill

- Diskutimi për miratim i draft projektit të VKM-së “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të KKK-së” që del në zbatim të ligjit të ri për kontabilitetin;
- Diskutimi mbi draftin e strukturës së manualit në zbatim të SKK 13, seksioni i aktiveve biologjike;

Maj

- Informacion nga stafi për të dhënat e siguruar nga tatimet mbi xhiron, aktivin dhe numrin e të punësuarve e mikronjësive, të ndarë në disa nënkategori;
- SKK 15 – Amendimi sipas ligjit të ri për kontabilitetin
 - Kufiri për zbatimin e kontabilitetit monetar
 - Fusha e zbatimit

Qershor

- Diskutimi i manualit të zbatimit të SKK 13 në kontabilitetin bujqësor (Bashkëpunim me stafin e Universitetin Bujqësor, Tiranë);
- Diskutimi i tabelës së përputhshmërisë së Dir 34/2013 me kuadrin vendas të raportimit;

Korrik

- Diskutimi për vendimin mbi rishikimin e SKK-ve të tjera pas miratimit të ligjit të ri “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

- Diskutimi për vendimin mbi rishikimin e SKK 15 të përmirësuar, pas miratimit të ligjit të ri “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (referuar klasifikimeve të reja)

Shtator

- Draft SKK 15 e përmirësuar ‘e rishikuar’
- Për miratim – Përkthimi dhe rishikimi i ndryshimeve të SNRF-ve
- Diskutimi i tabelës së përputhshmërisë së Dir 34/2013 me kuadrin vendas të raportimit (pjesa e dytë)

Tetor

- Draft ndryshimet në SKK-të (1-14) pas miratimit të ligjit të ri

Nëntor

- Për miratim dhe publikim - Manuali për zbatimin e SKK 13 në kontabilitetin bujqësor

Dhjetor

- Diskutimi i tabelës së përputhshmërisë së Dir 34/2013 me kuadrin vendas të raportimit (pjesa e tretë)

Stafi gjatë vitit 2018, ka përfunduar këto detyra:

- organizimin e trajnimeve për standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit në kuadër të projektit të Bankës Botërore “*Strengthening accountancy and audit education of financial statements preparers and tax employees, and technical capacities of the accounting and audit professions*”, ku KKK si ishte në rolin e koordinatorit;

- organizimin e Konferencës me temë “Përmirësimi i vazhdueshëm i raportimit financiar, kontribut në zhvillimin ekonomik dhe integrimin e vendit”;
- koordinimin e përkthimit dhe rishikimit të përditësimeve të SNRF-ve;
- rishikimin e SKK2 dhe SKK9 sipas udhëzimeve të Dir 34/2013 të BE
- përditësimin e tabelës së përputhshmërisë së Dir 34/2013 me ligjin dhe SKK-të;
- organizimin e takimeve studentore në rrethe të ndryshme të vendit;
- ripunime të udhëzuesit të SKK për OJF-të dhe propozime për ndryshime në udhëzuesin e SKK 13 “Aktivet biologjike”;
- përgatitja për ribotim e materialit “Plotësimi i pasqyrave financiare sipas SKK-ve të përmirësuara”;
- hartimin e draft rregullores së re të KKK-së, pas miratimit të Ligjit “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”;
- ridraftimin e fushës së zbatimit të SKK 15 pas hyrjes në fuqi të ligjit të sipërcituar;
- rishikimin e SKK3, SKK5, SKK11 dhe SKK 13 me objekt thjeshtimin e raportimit financiar për njësitë ekonomike të vogla;
- përgatitjen e pyetësorit në vijim të takimit të zhvilluar gjatë muajit Nëntor 2018 me përfaqësues të Bankës Botërore në kuadër të përgatitjes së “Accounting and Auditing Report on the Observance of Standards and Codes (A&A ROSC)” për vendin tonë. Të dhënat në pyetësor u plotësuan bazuar në ligjin e ri të kontabilitetit nr.25/2018.
- përgatitja e materialeve për MEPJ (*PKIE 2019 – 2021, për Kapitullin 6 “Legjislacioni Tregtar”*) ku paraqiten dhe adresohen zhvillimet më të fundit, rekomandimet e Komisionit Evropian të dhëna gjatë vitit 2018 dhe prioritetet për vitin 2019 e në vazhdim;

- angazhimi dhe kontributi në takimet e zhvilluara me ekspertin e huaj të caktuar nga MFE për implementimin e standardeve të kontabilitetit në Sektorin Publik

Gjithashtu, linearisht është punuar për të përmbushur të gjitha detyrat administrative të stafit, përfshirë hartimin, realizimin dhe raportimin e shpenzimeve buxhetore.

I. Trajnimet për SKK-të dhe SNRF-të

Në periudhën 15 janar – 4 mars 2018 u zhvillua faza e dytë për trajnimet e SKK-ve dhe SNRF-ve.

- Në Tiranë trajnimet për SKK-të u zhvilluan në 4 javë të njëpasnjëshme (15 janar – 11 shkurt);
- Në Tiranë trajnimet për SNRF-të u zhvilluan në tre fundjava të njëpasnjëshme (26-28 janar, 2-4 shkurt, 9-11 shkurt);
- Në rrethet Durrës, Fier, Shkodër dhe Korçë trajnimet u zhvilluan të ndara në dy fundjava çdo rreth në periudhën 2 shkurt – 4 mars;

Në përfundim të trajnimeve u grumbulluan këto statistika:

	DPT	IKM	KKK	MF	SHKFSH	SHKM	TOTALI
Regjistruar	264	234	240	7	316	43	1104
Mbi 75%	224	189	181	7	221	15	837
Nen 75%	40	45	59	0	95	28	267
Frekuentimi	85%	81%	75%	100%	70%	35%	76%

II. Organizimi i Konferencës

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit zhvilloi më datë 9 mars 2018, në mjediset e Hotel Tirana, konferencën "Përmirësimi i vazhdueshëm i raportimit financiar kontribut në zhvillimin ekonomik dhe integrimin e vendit". Pjesëmarrja ishte një nga sukseset e kësaj konference. Përballimi i shpenzimeve të saj u bë me fondet e KKK-së. Në total u shpenzuan 85.290 lekë nga të cilat 41.730 për përgatitjen dhe printimin e broshurës dhe banerit të konferencës ndërsa pjesa tjetër prej 43.560 lekë u shpenzua për qiranë e sallës. Shpenzimet për coffee break dhe drekës për të ftuarit u përballuan nga Grupi BALFIN, sponsorizimi i të cilëve u mundësua nga anëtari i Bordit, znj. Elona Koçi.

Konferenca e konceptuar në tre seksione solli 13 referime. Seksioni i parë bëri kryesisht një paraqitje të arritjeve të KKK-së në periudhën mbas konferencës më të fundit në qershor 2016 si dhe të mbështetjes që Banka Botërore i jep këtij Institucioni. Në këtë sesion pati një referim edhe Kryetari i Bordit të Mbikqyrjes Publike i cili ndër të tjera e vuri theksin tek domosdoshmëria e bashkëpunimit mes dy institucioneve si një premisë për shëndetin e cilësisë së raportimit financiar. Seksioni i dytë i dha hapsirën organizmave profesionalë të ngrenë problemet që ata hasin lidhur me zbatueshmërinë e ligjit dhe standardeve të kontabilitetit por pa u limituar vetëm në to. Në referimet e prezantuara kryesisht theksi u vu në rëndësinë e ekzistencës së tyre dhe nuk pati raste konkrete ku kërkohej bashkëpunimi apo problematika konkrete që mund të kërkonin zgjidhje nga KKK. Në seksionin e tretë i'u dha hapsirë aktorëve të tjerë si KLSH, UT, QKB, etj për të marrë prej tyre konsiderata apo sugjerime për bashkëpunime të mëtejshme. Nga UT erdhi kërkesa për bashkëpunim lidhur me praktikat e studentëve, bashkëpunimit për kurikulat universitare në lëndët e kontabilitetit, shkëmbimi i informacioneve mbi zhvillimet më të fundit në teorinë dhe praktikën e kontabilitetit, etj. Nga Institucionet e tjera nuk patëm sinjale të kësaj natyre por gjithësesi ishin të mirëpritur qoftë edhe për të ndarë me të ftuarit në sallë zhvillimet më të fundit në Institucionet e tyre.

III. Përkthimi dhe rishikimi i përditësimeve të SNRF-ve

IASB gjatë vitit 2017 ka dërguar disa materiale për azhornimet e vitit 2018 të cilat janë pjesë e versionit të konsoliduar 2018.

Azhornimet e mbërritura deri tani janë si në vijim:

<i>Titulli</i>	<i>datë efektive</i>
Ndryshime të SNRF 9	1 janar 2019
Ndryshime të SNK 28	1 janar 2019
Ndryshime të SNRF 17	1 janar 2021
Ndryshime të SNRF 3	1 janar 2019
Ndryshime të SNRF 11	1 janar 2019
Ndryshime të SNK 12	1 janar 2019
Ndryshime të SNK 23	1 janar 2019
Ndryshime të KIRFN 23	1 janar 2019

Materiali u dërgua për përkthim dhe ka mbaruar së përkthyeri. Më pas materiali i kaloi rishikuesve për rishikim. Stafi përfundoi në dhjetor konsolidimin e SNRF-ve, varianti 2018, dhe është në pritje të konfirmimit nga Londra që materiali është i

gatshëm për publikim (plotëson kriteret e formatimit sipas programit TRADOS). Me miratimin e formatit, varianti i konsoliduar 2018 do të publikohet në faqen e internetit të KKK-së.

IV. Rishikimi i SKK 2 dhe SKK 9 sipas udhëzimeve të Dir 34/2013 të BE

Pas mbledhjes së muajit janar, stafi publikoi për komente SKK 2 dhe SKK 9, të rishikuara në kontekstin e transpozimit të Dir 34/2013. Komenti i vetëm i ardhur gjatë tremujorit ka qenë ai i **Grupit Balfin**. Komentet e mbërritura u morën në shqyrtim nga stafi i cili përgatiti dhe një material sqarues për Bordin. Për aq sa u pa e nevojshme, komentet e Balfin u integruan nga Bordi në variantin e dytë të rishikuar të SKK 2 dhe SKK 9. Në respekt të rregullores, afati për komente ishte tre muaj por Bordi mori vendim për një shtyrje të tij deri në 25 korrik 2018. Nuk pati asnjë koment tjetër mbi këto standarde as nga persona fizik, as nga studiot kontabël apo të auditimit dhe as nga shoqatat profesionale. SKK 2 dhe SKK 9 janë dërguar për shpallje tek Ministri përgjegjës për financat që në muajin shtator 2018 por akoma nuk ka dalë Urdhri për shpalljen dhe publikimin e tyre.

V. Rishikimi i SKK3, SKK5, SKK11 dhe SKK13

Gjatë tremujorit të fundit stafi ka punuar për rishikimin e SKK 3, SKK 5, SKK 11 dhe SKK 13 me qëllim lehtësimin e barrës së raportimit për njësitë ekonomike të vogla. Ndryshimet e paraqitura në bord për këto standarde u miratuan në

mbledhjen e muajit dhjetor 2018 dhe kanë dalë për komente në faqen e internetit të KKK-së. Afati për komente është 3 muaj, për 2 herë rradhazi. Në korrik të vitit 2019 komentet apo sugjerimet e mbërritura do të paraqiten për shqyrtim në Bord.

VI. Tabela e përputhshmërisë

Nga analiza e tabelës së përputhshmërisë së përgatitur nga stafi i Bankës Botërore rezultuan shumë dispozita të pintegruara në kuadrin ligjor dhe të raportimit financiar në vendin tonë. Një pjesë ekëtyre ndryshimeve u reflektuan në ligjin e ri të kontabilitetit që hyri në fuqi në 1 janar 2019. Pjesa tjetër është parë e arsyeshme të jetë pjesë e standardeve. Disa prej tyre u përfshinë në SKK 2 dhe SKK 9 ndërsa pjesa e mbetur konsiderohen kërkesa të parakohshme për zhvillimet në mjedisin shqiptar të raportimit financiar. Në muajin korrik i është dërguar koleges në Vienë tabela e re e korespondencës mes Direktivës dhe SKK-ve përgatitur nga stafi i KKK-së. Informacioni i dërguar është një nga bazat mbi të cilën ka punuar stafi në Vienë për përditësimin e tabelës së përputhshmërisë.

VII. Takimet studentore

Në muajt janar - maj janë organizuar takime studentore respektivisht në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër si dhe në “Universitetin Fan S Noli” Korçë. Takimet ishin në vazhdim të iniciativës për të komunikuar me studentët e

kontabilitet financës në universitetet tona me qëllim prezantimin e rregullatorit të fushës ku ata do të kontribuojnë si dhe zhvillimet aktuale në këtë fushë.

Takimet u mirëpritën nga studentët dhe stafet akademike. Këtë gjë e dëshmoi më së miri pjesëmarrja shumë e madhe. Stafi i KKK-së në prezantimin e vet bëri një panoramë të disa çështjeve që i shikon të integruara me njëra tjetrën:

✚ Edukimi universitar bashkëkohor dhe mundësitë që të ofron edukimi kontabël:

- Karriera profesionale
- Karriera akademike

✚ Legjislacioni dhe asociimi

- Direktiva, ligji, disa VKM
- Rregullatori, statusi-rol-detyrat
- Aderimi, shoqatat dhe institutet

✚ Kërkesat për të filluar dhe vijuar një karrierë profesionale të suksesshme

- Ligji për rregullimin e profesionit të kontabilistit dhe audituesit ligjor
- Kërkesat për KM / Kërkesat për auditues

Në fund të takimeve kishte interesim shumë të lartë të studentëve për gjithçka u diskutua dhe për më tepër se aq. Megjithatë një takim nuk ezauron gjithçka, por i hap dyert shkëmbimit të informacionit përmes bashkëpunimit Institucional. Për këtë arsye mes institucioneve tona është nënshkruar dhe një marrëveshje bashkëpunimi.

VIII. Udhëzuesi i SKK për OJF-të

Udhëzuesi për zbatimin e SKK për OJF-të është publikuar nga KKK në korrik 2017. Megjithëse, si një përpjekje e parë, materiali konsiderohet i vlefshëm për OJF-të u pa e arsyeshme një ripunim i tij me synimin e qartësimit të disa prej kërkesave të SKK për OJF me qëllimin mundësimin e interpretimit të qartë të ngjarjeve dhe transaksioneve kontabël të OJF-ve. Rishikimi u bë nën asistencën e konsulentit të caktuar nga projekti i Bankës Botërore. Materiali i përmirësuar pas miratimit në Këshill u publikua për komente nga palët e interesit. Komente nuk pati e për rrjedhojë udhëzuesi i OJF-ve u publikua në faqen e internetit të Këshillit në shtator 2018.

IX. Ribotimi i materialit “Plotësimi i pasqyrave financiare sipas SKK-ve të përmirësuara”

Në vitin 2016 KKK –publikoi për herë të parë komentarin “Plotësimi i pasqyrave financiare sipas SKK-ve të përmirësuara”. Ky komentari u botua në 500 kopje të cilët u shitën deri në fillim të vitit 2018. Ato shërbyen për mbylljen e pasqyrave financiare 2016 dhe 2017. Nisur nga interesimi i profesionistëve, komentari u ribotua pa ndryshime nga teksti i parë. Sërish u botua në 500 kopje, kosto totale 75.000 lekë.

X. Draft Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të KKK-së

Me miratimin e ligjit të ri për kontabilitetin, KKK vendosi të punojë mbi rregulloren e organizimit dhe funksionimit të KKK-së për ta dërguar atë për shqyrtim pranë Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Materiali i miratuar nga Këshilli është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për ndjekjen e procedurave të mëtejshme të miratimit të saj.

XI. Rishikimi i SKK 15 “Kontabiliteti dhe raportimi financiar i mikronjësive”

Gjithnjë në vijim të ligjit të ri për kontabilitetin, u pa me vend ndërhyrja e rradhës në SKK 15 “Për raportimin financiar të mikronjësive”. Në këtë standard u rishikua fusha e zbatimit të tij dhe dispozita që parashikon limitin e sipërm të xhiros/aktivitetit të mikronjësive në funksion të aplikimit të kontabilitetit fiskal. Stafi me qëllim mbështetjen me evidencë të vendimit të Këshillit mblodhi një informacion nga DPT për mikronjësitet. Statistikat konsistojnë në të dhëna për numrin e mikronjësive të ndara në fasha të xhiros dhe numrit të të punësuarve. Gjithashtu stafi ka shfrytëzuar edhe publikimet vjetore të INSTAT për të zgjeruar bazën e të dhënave të nevojshme për vendimmarrjen.

SKK 15 e rishikuar u publikua në faqen e internetit për komente me afat deri 10 janar 2019. Nuk ka patur asnjë koment me shkrim apo me gojë nga palë dhe individë të interesuar e për rrjedhojë materiali do të paraqitet për miratim nga Bordi në mbledhjen e rradhës e më pas do të dërgohet për shpallje nga Ministri përgjegjës për financat.

XII. DETYRA TË TJERA

a) Pyetësi për vetvlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2018

Nga ana e stafit të KKK plotësohet çdo vit pyetësi i vetvlerësimit i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin paraardhës. Ky pyetësor dërgohet çdo vit nga Ministria e Financës (është i disponueshëm dhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financës) dhe është i detyrueshëm për t'u dorëzuar çdo datë 1 Mars.

Ky dokument tregon përgjegjësitë kryesore të Nëpunësit Autorizues në kuadrin e implementimit të konceptit të përgjithshëm menaxherial. Me anë të tij bëhet vetvlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm brenda institucionit.

Ky pyetësor ka pesë komponentë:

1. Mjedisi i kontrollit
2. Menaxhimi i riskut
3. Aktivitetet e kontrollit
4. Informimi dhe komunikimi
5. Monitorimi

b) Deklarata, raporti mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2018 dhe plani i ngritjes dhe zhvillimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit

Pas plotësimit të pyetësit të mësipërm Nëpunësi autorizues hartoi dhe deklaraten e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm për institucionin.

Nëpunësi autorizues deklaron përgjegjësinë për menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve financiare dhe jofinanciare të njësisë, monitorimin që i ka bërë sistemit të kontrollit të brendshëm të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit gjatë vitit raportues 2017 duke krijuar një mjedis kontrolli, menaxhimi të riskut, veprimtarisë së kontrollit, nëpërmjet marrjes së informacioneve dhe komunikimeve të vazhdueshme me vartësit, nëpërmjet vlerësimeve dhe analizave në vazhdimësi, nëpërmjet vendosjes së një sistemi rregullash dhe procedurash të brendshme të njësisë.

c) Faqja e internetit – programi i transparencës

Në bazë të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, stafi përditëson programin e transparencës me frekuenca tre mujore. Publikohen në faqen e internetit regjistri i prokurimeve (parashikimi dhe fakti) si dhe shpenzimet buxhetore. Në linkun e posaçëm publikohen edhe vendimet e rëndësishme të Bordit. Për vitin 2018 gjithçka është publikuar sipas kërkesave të ligjit të sipërcituar.

d) Kthim përgjigje subjekteve

Tashmë është një rutinë normale pune që subjekte të ndryshme i drejtohen me shkresë ose me email stafit të KKK për interpretime apo sqarime lidhur me standardet apo udhëzuesin në zbatim të tyre. Përgjigjet, shkresore apo përmes emailit publikohen më pas në faqen zyrtare me qëllim që t’u shërbejnë dhe njësisë të tjera që mund të hasin të njëjtat paqartësi në punën e tyre.

e) Pyetësi për ROSC

f) Raportimet periodike për Ministrinë e Punëve të jashtme integrimin

g) Angazhimet si pjesë e grupit të punës për hartimin dhe implementimin e IPSAS

Tiranë 23.01.2019